



Datë: 08.01.2026
Numër Protokolli: 67/2026

A.nr.1861/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktar, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj- Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1861/2025, të datës 03.11.2025, të parashtruar nga ankuesja A.M si dhe ankuesja F.K, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson ankuesja A.M, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura lidhur me ankesën me numër A.nr.1861/2025, të datës 03.11.2025, të parashtruar nga ankuesja A.M si dhe ankuesja F.K.

A r s y e t i m

Nëpunëset civile A.M dhe F.K (në tekstin e mëtejme referuar: ankueset), më datë 24.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 05-7750 të datës 08.10.2025, të Ushtruesit të Detyrës të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, përmes të cilit vendim ankueseve i’ u është refuzuar kërkesa për kompensimin e funksionit shtesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në provat e lëndës konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për pezullimin e procedurës administrative lidhur me ankesën e parashtruar nga ankueset A.M dhe F.K, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankueset janë të punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, përkatësisht ankuesja A.M, sipas Akt emërimit me Nr-088 të datës 12.03.2012, është e punësuar në pozitën e punës *Inspektore Shëndetësore*, ndërsa ankuesja F.M, sipas Akt emërimit me numër protokolli 05-54903 të datës 27.06.2025, është e punësuar në pozitën e punës *Udhëheqëse e Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit*.

Tutje, Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, përmes Vendimit me Nr.114/VII/2023 të datës 14.07.2023, ka emëruar Komisionin e Ankesave ndaj vendimeve të Bordit për Shkollim Specialistik, ku si rrjedhojë ankuesja A.D, është emëruar kryesues, ndërsa ankuesja F.K, është emëruar anëtare.

Ankuesja A.M, në cilësinë e Kryesueses së Komisionit të Ankesave ndaj vendimeve të Bordit për Shkollim Specialistik, përmes kërkesës me numër protokolli 05-2251 të datës 25.03.2025, i është drejtuar me kërkesë Udhëheqësit të Divizionit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë, për kompensimin e funksionit shtesë dhe atë nga data 17.07.2023 deri në shqyrtimin e kësaj kërkesë, mbi bazën ligjore sipas nenit 44 të Udhëzimit Administrativ 01/2023 për Shkollim Specialistik si dhe Vendimit nr.prot.885/2023 të datës 06.02.2025 të KPMSHCK-së. Mirëpo, e njëjta nuk kishte pranuar përgjigje ashtu që me datë 03.06.2025, ka informuar organin e punësimit se është në pritje të kësaj përgjigjeje.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë përmes Vendimit me Nr.408/VI/2025 të datës 05.06.2025, ka refuzuar kërkesën e ankueses për funksion shtesë, me arsyetimin se Ministria e Shëndetësisë lidhur me pagesat e trupave profesionale (borde dhe komisione), bazohet në Procedurën Standarde Operative (PSO) me nr.prot.05-7542 të datës 23.11.2023, e cila ndër të tjera parasheh: ***“Zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë të cilët shërbejnë në borde, komisione dhe trupa tjerë profesionale nuk marrin kompensim për angazhim e tyre në këto trupa”.***

Ankueset, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.408/VI/2025 të datës 05.06.2025, pretendonin se Komisioni i Ankesave ndaj vendimeve të Bordit për Shkollim Specialistik, bazuar në nenin 44 të Udhëzimit Administrativ 01/2023 për Shkollim Specialistik si dhe Vendimin me Nr.114/VII/2023 të datës 14.07.2023, kompensohet sipas ligjit për pagat në sektorin publik, gjithashtu të njëjtat pretendimin e tyre e mbështetin edhe në nenin 8 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërlidhur me Vendimin A.nr.2012/2024 dhe numër prot.885/2023 të datës 06.02.2025 të KPMSHCK-së. Andaj, ankueset kanë kërkuar aprovimin e ankesës, anulimin e vendimit kontestues me obligimin që organi i punësimit të bëjë kompensimin për funksion shtesë në mënyrë retroaktive, dhe atë që nga data e hyrjes në fuqi të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë.

Ndërsa, Këshilli, përmes Vendimit A.nr.1204/2025 të datës 02.09.2025, kishte shfuqizuar Vendimin me Nr.108/VI/2025, të datës 05.06.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, ndërsa lënda e ankueseve ishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, me obligimin që ky i fundit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të rishqyrtoj dhe vendos për kërkesën e palës ankuese me numër protokolli 05-2251 të datës 25.03.2025 dhe të nxjerr aktin administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi duke marr për bazë pikëpamjet e dhëna juridike si në këtë vendim.

Si rrjedhojë, Ushtruesi i Detyrës i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, me datë 08.10.2025 ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 05-7750, përmes të cilit akt ka refuzuar kërkesën e ankuesve me numër protokolli 05-2251 të datës 25.03.2025, me arsyetimin se nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kriteret për kompensimin e funksioneve shtesë, të përcaktuara nga neni 5 paragrafi 2 i Rregullores (QRK) Nr.10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë, gjegjësisht kriteri 2.6.

Ankueset, kundër vendimit të lartë theksuar kanë parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimet ankimore se kanë të drejtë në kompensimin e shtesës në emër të funksionit shtesë për shkak të angazhimit në Komisionin e Ankesave ndaj vendimeve të Bordit për Shkollim Specialistik, sepse bazuar në nenin 44 të Udhëzimit Administrativ 01/2023 për Shkollim Specialistik si dhe Vendimin me Nr.114/VII/2023 të datës 14.07.2023, ky komision kompensohet sipas ligjit për pagat në sektorin publik, gjithashtu të njëjtat pretendimin e tyre e mbështetin edhe në nenin 8 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërlidhur me Vendimin A.nr.2012/2024 dhe numër prot.885/2023 të datës 06.02.2025 të KPMSHCK-së. Rrjedhimisht, ankueset kërkojnë aprovimin e ankesës, anulimin e vendimit kontestues me obligimin që organi i punësimit të bëjë kompensimin për funksion shtesë në mënyrë retroaktive, dhe atë që nga data e hyrjes në fuqi të Rregullores (QRK) Nr. 10/2023 për Kompensimin për Funksione Shtesë.

Marrë parasysh së objekti i ankesës ka të bëjë me kompensim për funksion shtesë dhe duke qenë së Këshilli për çështja të njëjtë dhe institucion të njëjtë, me Vendimin A.nr. 32/2024 të datës 23.02.2024, kishte refuzuar ankesën e ankuesve R.H, J.G, H.S, T.A. Sh.U.H dhe A.M, vendim ky i anuluar nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.1411/2024, të datës 27.08.2025, e më të cilin aktgjykim është detyruar Ministria e Shëndetësisë që ankuesve t'i bëjë kompensimin në emër të angazhimit për punë shtesë si kryesues dhe anëtarë të trupave profesionale. Ndërsa, Këshilli kundër aktgjykimit A.nr.1411/2024, të datës 27.08.2025, ka parashtruar ankesë më datë 03.11.2025 në Gjykatën e Apelit, më të cilën konteston Aktgjykimin A.nr.1411/2024, të datës 27.08.2025, për shkak të shkelje të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Andaj, mbi këto rrethana, dhe duke qenë së aktgjykimi A.nr.1411/2024, i datës 27.08.2025, nuk është përfundimtar pasi që Këshilli ka ushtruar ankesë kundër të njëjtit, Kolegji në mbështetje të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: ”çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”*, vendosi për pezullim të procedurës të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1861/2025, të datës 03.11.2025, të parashtruar nga ankueset A.M dhe F.K.

Procedura do të mbetet e pezulluar deri në vendimin përfundimtar lidhur me çështjen administrative/ gjyqësore A.nr.1411/2024.

Duke u bazuar si me lartë dhe në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1861/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësueses së autorizuar, ankueses A.M;
- Sekretarit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrinë e Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.